

 REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	Data Datum Date:
Dalëse	

0224/4
1485-1/2024
13/06/2024
PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Gazmend Muhaxheri , Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj , Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahmeti , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Enis Spahiu , Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 06.06.2024
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Razije Murtezaj , Zyrtare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 3. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Besiana Kurshumliu , Zyrtare e Lartë për Vlerësimin e Ndhmës Shtetërore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Referencë: 91 /2024
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Pejës	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Muhaxheri,
I nderuari Kryesues z. Kurtbogaj,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin Nr.21/2024 për mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelerve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë, shuma prej 28,000 euro</i>
<i>I miratuar më datë 28.05.2024</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 31.05.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 03.06.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Pejës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Pejës, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelerve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë, shuma prej 28,000 euro.
2. Përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjin Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7

Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë **dispozitat e aplikueshme të LMFPP** gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMFPP-së është neni 81 i LMFPP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet

dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMFP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

Neni 81

Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, **dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. [theks i shtuar]**

4. Në rrjedhë të kësaj, LMFP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfilltë të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.
5. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMFP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga **fondet e ndara dhe të alokuara** [theks i shtuar].
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin me Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Pejës, ku është evidentuar se komuna i ka të planifikuara dhe të lira ndarjet buxhetore në nën-programin Zyra e Kryetarit nga fondi burimor 21 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Për më tepër, akti komunal i plotëson kriterin për t'iu nënshtruar rregullave të Ndhmës Shtetërore të përcaktuara me Ligjin Nr.05 /L-100 për Ndhmën Shtetërore (LNSH), gjegjësisht neni 7, si në vijim:

Nenin 7: Ndhma “De Minimis” të LNSH, nëse kemi të bëjmë me përfitime në vlerë deri në 200,000 EUR (për 3 vite fiskale, për secilin subjekt afarist), dhe kështu sipas Neni 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2020 Për Ndhmën “De Minimis”, institucioni dhënës obligohet që brenda 15 ditësh pas dhënies së ndihmës të raportojë nëpërmjet formularit të njoftimit konform Shtojcës 1 dhe 2 të Rregullores, në Departamentin e Ndhmës Shtetërore.

8. Po ashtu gjatë shqyrtimit të aktit komunal, Ministria ka evidentuar se përfituesi i subvencionit ka statusin e Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) në Sistemin Elektronik të Organizatave Jo-Qeveritare (SEOJQ).
9. Për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legjislative të Ministrisë evidentohen si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (këtej e tutje referuar si ‘Rregullore për Financimin e OJQ-ve’). Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.

10. Në rastin konkret, Ministria nuk ka pranuar dëshmi nga Komuna e për të konstatuar nëse subvencionimi i OJQ-ve të cilat janë përfituese, është realizuar konform dispozitave të Rregullores.

11. Mbi këto sqarime, Ministria sqaron se Komuna e Pejës ka mjete të buxhetuara dhe të lira për zbatimin e aktit komunal për këtë vit fiskal, mirëpo duke marrë parasysh se akti komunal ka të bëjë me financimin publik të OJQ-ve, aktit i konfirmohet ligjshmëria vetëm nëse janë zbatuar dispozitat e Rregullores për Financimin e OJQ-ve, ndërsa nëse këto dispozita nuk janë respektuar atëherë akti mbetet i pazbatueshëm.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Pejës, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

DOKUMENTI I DOKUMENTACIONIT
 Dokumentacioni i Dokumentacionit të Pushtetit Lokal
 Dokumentacioni i Dokumentacionit të Pushtetit Lokal
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration
 Nr. 020-371/1
 03.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
 Republika e Kosovës
 02/MAP/189 1485/2024
 03.06.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, U.d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Pejës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Pejës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela U.d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbiln Hetemi, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Data: 31.05.2024 Nr.020-371
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës 2. Zyrtari përgjegjës Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave për hartimin e shkresës përcjellëse	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MRPT	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr.21/2024 për mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelereve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Pejës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr.21/2024 për mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelereve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë.

I miratuar më datë: 28.05.2024.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.05.2024.



REPUBLIKA E KOSOVES
 REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJES / MUNICIPALITY OF PEJA / OPSTINA PEJE

KUVENDI KOMUNAL PEJE
 I Numër: 400-01/37995, datë: 28 Maj 2024.

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 2 pikë 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, Ligjin Nr. 08/L-280, Ligjin Nr. 08/L-281 dhe nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 01/L-016/01-413431-30 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe nenit 1.4 të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431-30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, me propozim të kryetarit të Komunës, marrë këtë:


Data: 31.05.2024		
Lloji: []		
Drektor: []		
Shprehësja/autoriteti	Titulli	Vlera
-11-	020-377	

VENDIM
 Nr. 21/2024

Për mbështetje financiare të Shqoqatës së Zestareve, Hotellereve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë me seli në Pejë

- MIRATOHET** propozimi i kryetarit të Komunës së Pejës, për mbështetje financiare (Subvencionimi) të Shqoqatës së Zestareve, Hotellereve dhe Afaristëve me seli në Pejë, në shumën prej 28,000.00€ (njëzet e tetë mijë euro), ky subvencionimi bëhet me qëllim që të ruhen zërat e vjetra e që të mos shuhen.
- Mjetet nga pikë 1 e këtij konkluzioni do të përdorohen nga Buxheti Komunal Pejë i zyrës së Kryetarit, kodit Subvencionie.
- Të përzgjedhesh sipas shprehës 1. Lista e dorzuar nga SHZHA, do të përfshijë secili në vlerë prej 2,000.00€, ku vlera totale e këtij subvencionimi do të jetë 28,000.00€. Kjo vlerë e mjeteve do të transferohet në llogarin e Shqoqatës së Zestareve, Hotellereve dhe Afaristëve me seli në Pejë.
- Përzbatimi e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të KK. Pejë.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi të dërgohet:
 MAH,
 MEPT,
 Kryetari të Komunës,
 DBP – ca,
 Arkiv.



Shtojen 1.

TE përzgjedhurit sipas listës së dorëzuar nga SHZETA-së, janë:

1. Burim Gorani: *Birskëpunues;*
2. Lulzim Bruqi: *Mbathëtar;*
3. Jeton Shëhri: *Mbathëtar;*
4. Shofqet Bajrami: *Farkatar;*
5. Parid Fetahu: *Farkatar;*
6. Gëzini Muriqi: *Farkatar;*
7. Nexhet Belegu: *Sarag;*
8. Ymer Turfaha: *Sarag;*
9. Arben Belegu: *Sarag;*
10. Hysen Morina: *Nalëpunues;*
11. Bajram Bardhi: *Leshliud;*
12. Afrim Lata: *Qelëpunues;*
13. Vllaznim Lata: *Qelëpunues;*
14. Avdullah Dula: *Tabak.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEÇ

SKUPŠTINA OPŠTINE PEÇ

L.Nr. 400-01/37995, datë: 28 Maj 2024.

Na osnovu člana 11 i 12 stav 1 i 2 slovo d) i člana 24 Zakona br. 03/L-40 o Lokalnoj Samoupravi Republike Kosova, člana 2 tačka 2.3 Zakona br.03/L-049 za Finansije Lokalne Vlasti, i Zakona br.03/L-048 za Menadžiranje javnih finansija i Odgovornost, dopunjeno i izmenjeno sa Zakonom br.03/L-221 i Zakonom br.04/L-116, Zakonom br.04/L-194, Zakonom br. 05/L-063, Zakonom br.05/L-007, Zakonom br.08/L-260 o Budžetu Republike Kosova za 2024 godinu, i člana 20, stav 1 tačka 1.4 Statuta Opštine Peç, i Br. 01-016/01-4/3431 od 30 septembra 2020, Skupština Opštine Peç, na sednici održanoj dana 28. Maja 2024 Godine, na predlog Gradonačelnika Opštine, donela je sledeću

Datum: 21.05.2024		
Mesto: Peja		
Opština: Peja		
Broj: 420-37		

ODLUKA
Br.21/2024

Za finansijsku podršku Zanatsko Ugoštiteljskog i Privrednog Društva (ZUPD) sa sedištem u Peçi

- USVAJA SE PREDLOG** Gradonačelnika Opštine Peç, za finansijsku podršku (Subvencije) zanatsko Ugoštiteljskog i Privrednog Društva, sa sedištem u Peçi, u iznosu od 28,000.00€ (dvadesetosam hiljada eura), ova se subvencija daje sa ciljem zaštite od gašenja starih zanata.
- Sredstva iz stava 1 ove odluke participiraju se od Budžeta Opštine Peç, Kancelarije Gradonačelnika, kod Subvencije.
- Izbor je izvršen shodno prilogu 1. Liste dostavljene od ZUPD, svaki će profitirati u iznosu od 2,000.00€, gde ukupna vrednost ove subvencije iznosi: 28,000.00€. Ovaj iznos sredstava će se preraspodeliti na članove Zanatsko Ugoštiteljskog i Privrednog Društva, sa sedištem u Peçi.
- Za sprovođenje ove Odluke starat će se Gradonačelnik Opštine u saradnji sa Direktoratom za Budžet i Finansije SO-a Peç.
- Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registrovanja u protokol nadležnog Ministarstva za Lokalnu Samoupravu kao i 7 (sedam) dana po objavljivanju na službenoj web stranici Opštine Peç.
-

Odluku dostaviti:
MALU,
MRFT,
Gradonačelniku,
DBP - os,
Arhiv.



Prilog 1.

Izabrani shodno Listi dostavljenoj od strane ZUPD –va su:

1. Burim Gorani: *Blyskëpinues;*
2. Lulzim Bruci: *Mbahës;*
3. Jeton Shehu: *Adhës;*
4. Shefqet Bajrami: *Farkatar;*
5. Parid Fetahu: *Farkatar;*
6. Gëzim Muriqi: *Farkatar;*
7. Nexhet Belegu: *Saraq;*
8. Ymer Turjaka: *Saraq;*
9. Arben Belegu: *Saraq;*
10. Hyson Morina: *Nalëpunues;*
11. Bajram Bardihi: *Leshkues;*
12. Altin Lata: *Qelëpunues;*
13. Vllaznim Lata: *Qelëpunues;*
14. Avdullah Dula: *Tabak.*